



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPSTINA NOVO BRDO
DOKËZË - IZLAZNA

Nomer 01 - 436
Mësimi 11.09.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në
bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më
18.09.2018 (e martë) duke filluar ne ora 10:00.

R e n d i i d i t ē s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Shqyrtimi i propozim bugjetit për vitin 2019 - 2021;
3. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më: 11.09..2018
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo-Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 27.08.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Anëtarët e KPF-së: Nebojsa Arsic, Xhejlane Behluli, Milica Jovanovic, Ramush Mehmeti, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, Zyrtari i DBPZHR Avdi Vllasaliu.

Kryesuesi pasi përvendoset që pranishmit tha: para se të fillojmë me punën e KPF-së dhe rendin e ditës duhet konstatuar korumin prezentë janë 4 antarë të KPF-së nga 5 gjithësej mungon Predrag Stojkovic me arsyet e kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

Rendite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Draft Buxheti për vitin 2019/2021;
3. Raporti mbi përfundimin e korrije-shirjeve për vitin 2018;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Ramush Mehmeti pasi përvendoset që pranishmit tha: siç po shihet situata një ditë do ta mbajmë KPF dhe Kuvendin me dy pika në rend dite, aprovimi i procesverbalit dhe të ndryshme. Unë e kam një propozim për seancë të Kuvendit që të hynë edhe dy pika shtesë të rëndësishme, pika e parë është gjendja në shendetësi konkretishtë hapja e ambullantes në Llabjan pasi që një vit ka përfunduar ndërtimi i saj por ende nuk është funksionalizuar, pika e dytë të diskutohet qështja e KEDS-it, pasi që më herët ka pasur kujdestari, tanë fatkeqësishtë kjo nuk po ndodhë, paramenoni një ndalje e sigureses qytetarët mbresin pa rrym për tri apo katër orë, andaj kishte qenë mirë që keto pika të dërgohen në Kuvend të diskutohet dhe të dërgohet një shkresë në Prishtinë pasi që ne paguajm sherbim.

Kryesuesi tha: plotësishtë pajtohem me ju, kemi diskutuar edhe me herët për gjendjen në shendetës, nese nuk keni tjera propozime i votojmë këto pika që të shkojnë në Kuvend.

Pasi nuk pat propozime tjera rendi i ditës u aporvua njëzëri nga të gjithë antarët prezent të KPF-së me këto dy pika shtesë të propozuara, pika e parë e propozuar është Raportimi i Drejtorisë së shendetësisë se deri ku kan arritur punët rrëth transferimit nga objekti i vjetër në objekt të ri dhe pika e dytë problemet me furnizim të rrymes dhe mungesa e kujdestarisë në Komunën e Novobërdës.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pat diskutime kjo pikë u votua njëzëri nga të gjithë antarët prezent të KPF-së.

Pika e dytë: Draft Buxheti për vitin 2019/2021;

Kryesuesi tha: ju e dini se ne me 6 shtator nuk do ta aprovojm buxhetin por do ta aprovojm ne fund të shtatorit dhe me 6 shtatorë do të diskutojm përseni dhe tash jemi në fazën e debateve publike më qytetarë dhe me antarët të Kuvendit, ne kemi pasur në javen e kaluar një debat me antarët e Kuvendit dhe përfaqësuesit e OSBE-es ku është diskutuar për hartimin e buxhetit. Duke e pasur parasysh se me ligj edhe Kuvendi është i obliguar që të organizoj një debat publik për propozim buxhetin për vitet e ardhshme, por daten e mbajtjes së këtij debati do ta caktojm në mbledhje të Kuvendit por ky debat duhet të realizohet deri ka mesi i shtatorit.

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Drejtitorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi përshendetë të pranishmit tha: besoj se ju të gjithë me kohë e keni marrë materialin, ky është vetëm propozim buxheti për vitin 2019/21. Buxheti në total është mbi 2 milion euro, kemi rritje të buxhetit krahasur me vitin e kaluar, për vitin ardhshëm paga dhe meditje jan planifikuar 1,903,481€, përmallra dhe sherbime 309,716€, për shpenzime komunale 66.000€, për subvencione 30.000€ dhe shpenzime kapitale 243,597€, i kemi disa propozime që i kemi dhënë si Drejtori për shpenzime kapitale por ato do ti finalizojm pas diskutimeve me qytetarë, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin përkëtë pikë.

Xhejlane Behluli pasi përshendetë të pranishmit tha: e di që është vetëm një draft propozim për buxhetin 2019/21, e di që e kemi degjime publik andaj ju kisha lut që ti merrni seriozishtë dhe mos ta votojm shablon këtë buxhet për tri vitet e ardhshme, qështja tjetër është pasi që e di se Kryetari i Komunës bashkpunon me përfaqësuesit e fshatrave dhe kërkosat mirren direkt prej përfaqësueseve mirëpo kisha kërkoi që të mirren parasysh edhe kërkosat e tona pasi edhe ne e përfaqësojm fshatin, pasi që përfaqësuesit e fshtarave jan zgjedhur politikishtë dhe ju sherbejn vetem qytetarëve ku kan marr vota por nuk duhet bërë përashtime sa i përket kushteve për përmirsimin e jetesës së qytetarëve, unë vi prej fshatit Pasjak dhe ka lagje ku i ka mbi 200 banor dhe nuk ka infrastruktur rrugore, është lagje e re por edhe ata janë banorë të Komunës së Novobërdës, unë do ti ftoj në dëgjim publik të gjithë banorët dhe ju kisha lut jo vetem aty por në të gjitha dëgjimet ti merrni seriozisht propozimet e tyre, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: jam i sigurt se edhe Kryetari i Komunës merr pjesë në këto debate publike, ju si antarë të Kuvendit merrni pjesë në këto takime dhe e keni mundesin ti cekni problemet, ne do ti marrim në konsiderat ato të cilat mundëti mbulojm dhe pas kësaj me 30 shtator e kemi mbledhjen finale ku ju do ta merrni materialin me kohë dhe do të shikoni se a janë hyr apo jo propozimet e juaja.

Kryesuesi tha: edhe une po kyçem në këtë diskutim, siç është përmendur edhe më herët se problemet më të mëdha janë në arsim dhe shëndetësi por po e shof se shpenzimet kapiale si në arsim ashtu edhe në shëndetësi jan rritur për 5.000€ por a egziston mundësia që të rriten më shumë?

Sercan Todorovic tha: këto jan mjete të cilat jan ndar vetem për gëlqerosje/ngjyrosje të objekteve shkolllore.

Xhejlane Behluli tha: në KPF-ën e kaluar kur ishte prezent edhe Kryetari direkt unë i kam paraqitur këto probleme rrith qendrave të mjekësisë familjare, kemi diskutuar edhe në mbledhje të Kuvendit por si duket nuk po mirren parasysh.

Ramush Mehmeti tha: ne të hyrat vetanake mundëti ndajm si duam vet, ne gjatë gjithë kohës po e cekim se kem nevoj për investime në shëndetësi dhe arsim pasi që kemi një gjendje të mjerueshme, por ndahen 40.000€ per investime kapitale ne bujqësi edhe pse nuk janë të nevojshme mirëpo du të them se në politik më shumë po shikohet se kush po sjell vota më shumë se kush po kryen punë, paramandoni kam qenë në ambulant dhe mungon anastezioni, andaj është mirë që të marrin masa pasi që ne jemi të zgjdhur nga qytetarët dhe duhet tju krijojm kushte qytetarëve dhe deri me 30 shtator është mirë të diskutojm bashkarishtë, pasi që asnjë propozim buxhet nuk është final dhe deri në aprovim kem mundësin të ndryshohet apo plotësohet, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: nese nuk ka diskutime tjera e kalojmë ne votim që këtë pikë ta dergojm në Kuvend.

Pasi nuk pat diskutime tjera kjo pikë u votua njëzëri nga të gjithë antarët prezantë e KPF-së që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Raporti mbi përfundimin e korrje-shirjeve për vitin 2018;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën ZDPZHR Avdi Vllasaliu.

Avdi Vllasaliu pasi përshendetë të pranishmit tha: këtë raport të cilin ju kemi derguar juve antarëve të Kuvendit ne e kemi dërguar edhe në Ministri të Bujqësisë, përafërsishtë jan kultivuar rrith 1100 hektar grur, të

tjerat i keni të paraqitura në raport. Procesin e korrije-shirjeve e kemi vëzhguar gjatë gjithë kohës, probleme nuk kemi pasur vetem se kushtet atmosferike kan penguar pak por gjith procesi ka përfunduar në rregull. Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi tha: pasi nuk ka diskutime e kalojmë ne votim që këtë pikë ta dergojm në Kuvend.

Pasi nuk pat diskutime tjera kjo pikë u votua njëzëri nga të gjithë antarët prezent të KPF-së që të shkoj në Kuvend.


Pika e pestë: Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Procesëmbajtëse

Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit

Nebojsa Arsic

